

MATERIALE DHE DOKUMENTE**VALTER MEMISHA****Q. MURATI, *FJALOR I FJALËVE DHE SHPREHJEVE NGA TROJET E SHQIPES NË MAQEDONI, SHKUP, 2015***

Q. Murati veçohet për prurje shkencore, që rrokin disa fusha të gjuhësisë dhe trupëzojnë një punë shkencore profesionale të kurorëzuar suksesshëm. Ai tashmë është identifikohet si një leksikograf shumë prodhimtar në një rrugëtim 35-vjeçar (të cilin e ka nisur si bashkautor me veprën *Fjalor i fjalëve të huaja*, Prishtinë, 1987), duke zënë një vend të merituar veçanërisht në leksikografinë dialektore mbarëkombëtare shqiptare. Gjatë punës, për dekada të tëra, ai ka pasur për busull, siç pohon dhe vetë porosinë e akademikut E. Çabej se “*Pasuria gjuhësore që rron nëpër dialekte vazhdon të përbëjë një gurrë ende të pashterur. Pa mbledhjen e leksikut dialektor dhe krahinor nuk mund të ketë gjuhë standarde shqipe dhe zhvillim të mëtejshëm të saj deri në nivelin e gjuhëve të tjera të përparuara të Evropës e të botës. Vetëm malësitë i ruajnë fjalët e shqipes se qytetërimi nuk ruan asgjë*”.

Ndër të tjera, në vitin 2015, Q. Murati boton në Shkup veprën madhore *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes të Maqedonisë*. Vepra sjell një numër të madh njësisish leksikore, frazeologjike e semantike dhe vlerat e saj janë të mëdha, duke sendërtuar, së pari, pasionin e gjuhëtarit dhe sedrën e atdhetarit për të qëmtuar e regjistruar çdo njësi që i përket shqipes, nga goja e popullit apo kudo që ato gjenden.

Fjalorët, që ky studiues ka hartuar, u përkasin disa grupeve tematike:

a. Fjalorë të mirëfilltë leksikorë: *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998; *Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë*, Logos-A, Shkup 2003; *Fjalor i sllavizmave në të folmet shqiptare të Maqedonisë*, Albas, Tiranë, 2004; *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes të Maqedonisë*, ITShKSh, Shkup, 2015 dhe *Fjalori i fjalëve dhe të shprehjeve të Kosovës*, Prishtinë, 2018.

b. Fjalorë që lidhen me kulturën e gjuhës dhe komunikimin gjuhësor: *Gjuha e medieeve – fjalor i gabimeve gjuhësore* IAP, Prishtinë, 2008; *Fjalor i gabimeve gjuhësore – Këshilla për t’u shprehur saktë dhe bukur*, ITShKSh, Shkup 2013; *Fjalor i medieeve*, ITShKSh, Shkup 2008.

c. Fjalorë toponomastikë: *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Tetovë, 2008

d. Fjalorë terminologjikë: *Fjalor i termave dhe nocioneve linguistike*, ITShKSh, Shkup, 2017

e. Fjalorë tematikë dygjuhësh: *Fjalor idiomatik shqip – maqedonisht*, Çabej, Tetovë, 2003.

Duke i parë nga afër e drejtpërdrejt këto vepra, që e pasurojnë ndjeshëm fondin leksikografik të shqipes, veçojmë këtu një tipar të spikatur të prurjeve shkencore të gjuhëtarit Q. Murati: ai duke ecur në gjurmët më të mira të dialektologëve shqiptarë të terrenit, në të gjitha punimet e veta, që nga ai i botuar në vitin 1990 e deri tek i fundit që kemi në duar, pra, jo vetëm në veprat e mirëfillta leksikografike, ka gjurmuar dhe qëmtuar nga goja e popullit pasuri të vlerësueshme fjalësore, frazeologjike e semantike me vlera të pallogaritshme. Le të përmendim këtu veprën monografike *Kërçova* (hulumtime gjuhësore, etnografike dhe folklorike) për të vlerësuar dhe këtë kahe të punës së këtij studiuesi të palodhur. Në brendësi të saj, në një vëllim me 55 faqe leksik dhe me 6 faqe frazeologji e fjalë të urta, numërohen qindra e qindra njësi që i takojnë pasurisë gjuhësore gojore popullore, dhënia e të cilave me gjithë elementet që kërkon puna leksikografike sot, sendërton një nga arritjet më të mira të autorit në këtë fushë.

Mjaftojnë vetëm këto të dhëna për botimet e shumta leksikografike, si dhe përvoja e pjekuria shkencore e autorit për të pranuar se vepra që kemi në duar, nuk mund të mos ishte e **arrirë** dhe që na sjell lëndë të begatë gjuhësore (së pari leksikografike), e cila u vjen në ndihmë mbarë studiuesve të gjuhës shqipe, por dhe përdoruesve të kësaj gjuhe në komunikimin e përditshëm, për ta intelektualizuar, por edhe për ta demokratizuar akoma më shumë shqipen e sotme.

Fjalori i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni, më vend të veçantë në leksikografinë dialektore dhe për atë mbarë kombëtare, me rëndësi të shumëfishtë e që mund të bëhet objekt pune për shumë studiues e për studime të shumë fushave, çka e vë në dukje vetë autori i veprës: “Me korpusin mjaft të larmishëm leksikor, për një areal të gjerë shqipfolës nga të folme të studiuara pak ose aspak, Fjalori do të ketë rëndësi për leksikografinë e leksikologjinë e përgjithshme të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera ballkanike, për dialektologjinë dhe historinë e gjuhës, për gjuhën e sotme letrare shqipe etj.”¹

Autori i veprës *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, 2015, është i ndërgjegjshëm për punën e bërë nga gjurmues dhe studiues para tij të fjalës shqipe, sidomos të asaj që gjallon në popull. Duke iu referuar gjuhëtarit të njohur kroat H. Bariçit, ai rimerr një të vërtetë të madhe, e

¹ Q. Murati, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, Shkup, 2015, f. 27.

cila e ka ngacmuar e shtyrë pandërprershëm për t'u përfshirë në procesin e mbledhjes së pasurisë gjuhësore popullore, për ta botuar atë e për ta bërë pronë të gjithë përdoruesit shqiptar e atij joshqiptar. Q. Murati shkruan se “*Fjalorë shqip ka shumë, por grumbullimi i lëndës së gjuhës popullore shqipe, në të vërtetë, gjendet vetëm në fazën fillestare*. Ky konstatim i mësipërm i lingjistit të madh të Zagrebit, Henrik Bariç, i shprehur këtu e gjashtëdhjetë vjet më parë në Fjalorin e tij madhor *Rečnik srpskoga ili hrvatskoga jezika (Fjalor i gjuhës serbishte ose kroatishite dhe i shqipes, Zagreb, 1950)*, ka vlerë reale edhe për gjendjen e sotme të botimeve tona leksikografike.”²

Vepra *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të shqipes së Maqedonisë - me mbi 20 mijë leksema, shprehje frazeologjike dhe toponime*” na tregon se Q. Murati ka punuar mirë shkencërisht dhe frytshëm funksionalisht, çka zbulohet që në shfletimin e parë fizik të saj. Ajo është e strukturuar në disa pjesë, madje pjesët që përfshihen në të, janë të vetëmjaftueshme dhe mund të qëndrojnë si punime monografike të veçanta³. Vetë autori shkruan se “Duke çmuar vlerën e madhe të visarit gjuhësor që gjendet në gojë të popullit dhe duke parë që kjo pasuri gjuhe dita-ditës po zhduket, i pata hyrë një pune të gjatë shumëvjeçare në vjeljen e fondit leksikor e frazeologjik nga të dialekteve shqiptare të Maqedonisë, që rezultoi me këtë Fjalor, që përveçohet për ngjyresën autoktone shqiptare dhe për vlera të veçanta gjuhësore. Në fjalorin e këtyre dialekteve përfshihet dhe një fjalës jo i pakët me burim nga maqedonishtja (rreth 1.200 leksema) dhe nga turqishtja (mbi 3.600 huazime)... Fjalori është i thurur edhe me lëndë të leksikut toponimik, me emra të vendeve (rreth 5.000 topoleksema), sepse edhe atje ruhet një pasuri shumë e madhe e fjalësit të gjuhës sonë në formë të ngurosur, të cilën leksiku i përditshëm e ka bjerrë nga përdorimi. Në

² Q. Murati, *po aty*, f. 11.

³ Shih më gjerë Pasqyrën e lëndës, por dhe gjithë lëndën e veprës **Preambulë; I. Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni** (Fjalor me pasuri të pamatë të thesarit leksikor e frazeologjik, Tekste nga ekspeditat në terren); **II. Fjalor frazeologjik** (Shprehje të ngulëta lidhur me situata të posaçme të jetës shoqërore, Tabu dhe eufemizma); **III. Fjalor i turqizmeve** (Turqizmat (orientalizmat) në ligjërimet shqiptare të Maqedonisë, Fraza idiomatike me elemente të turqishtes, Topoleksema me burim prej turqishtes, Emra vetjakë me burim nga turqishtja ose të hyrë përmes turqishtes); **IV. Fjalor i sllavizmave në shqipen e arealit të Maqedonisë** (Elemente leksikore të huazuara nga maqedonishtja, Glosar i sllavizmave maqedonase në dialektet e shqipes, Toponime me burim nga maqedonishtja), **V. Fjalor i albanizmave në maqedonishten** (Shqipja dhe maqedonishtja në kontaktet e tyre të ndërsjella gjuhësore, Albanizma leksikore, Albanizma toponimike, Albanizma patronimike); **VI. Fjalor idiomatik shqip-maqedonisht** (Shprehje paralele shqip-maqedonisht, Fraza me substancë idiomatike); **VII. Fjalor toponomastik** (Leksiku toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë, Fjalor patronimik). Shih më gjerë Q. Murati, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, Shkup, 2015.

lëndën e këtij Fjalori janë arkivuar dhe rreth 1000 njësi frazeologjike, fraza idiomatike, eufemizma etj., me vlera të veçanta etnolinguistike.”⁴

Lënda gjuhësore që ka zënë vend në Fjalor, vjen nga disa burime. Q. Murati shkruan se “Për grumbullimin e lëndës leksikore më është dashur t’u bija pash më pash ngulimeve shqiptare në Maqedoni, të qëmtoja këngët popullore shqiptare dhe literaturën e botuar dhe dorëshkrimore dialektologjike, folklorike etj., dhe të nxirrja prej atje “*fjalë plaka e të harruara*”, të cilat do t’i vlejné gjuhës si për përdorim praktik dhe si për punë të tjera studimore.”⁵

Te **Parathënia / Preambula** e veprës, autori ka bërë një vështrim thukësor të gjendjes së punës së studiuesve me fjalën në terren, si dhe ka theksuar fort shtysën e gjithë punës së tij madhore për gjurmimin e kujdesshëm, gjetjen e përzgjedhjen e fjalës që gjëllin në gojën e popullit. Ai, duke i njohur nga afër proceset që ndodhin në kohët e sotme në shoqërinë shqiptare (e jo vetëm), është i vetëdijshëm se zhvillimet e hovshme e përfshirëse çojnë në vdekjen e apo bjerrjen e një pasurie jo të vogël, së shumti leksikore e frazeologjike popullore, me vlera të pamata e të pazëvendësueshme dhe që shërben si një gurrë e pashtershme për të pasuruar fuqishëm leksikun normativ të shqipes standarde. Ai e shpreh shqetësimin e vet drejtpërdrejt e pa dorashka, kur shkruan se “E ne, nga ana tjetër, ankohe mi nga të gjitha anët që të folmet tona për çdo ditë po e humbasin pasurinë e tyre leksikore, frazeologjike, emërtimet gjeografike, dhe treten si kripa në ujë, pa lënë gjurmë fare. Dhe për çudi vazhdojmë të jemi indiferentë e të mos çajmë kokën aspak për këtë “vdekje të gjuhës”, pa e ditur se kjo është dhe vdekje jona. Vdekje jo vetëm e së shkuarës, por dhe e së ardhmes.”⁶

Dhe në linjën e parashtrimit të qëllimeve të punës së tij, parësisht shkencore (por jo më pak atdhetare), ai shkruan më tej se “Për ta ruajtur dhe arkivuar thesarin e çmuar leksikor, nga ajo pasuri që kemi trashëguar, ia nisa me punë të pandalshme ta shkruaja këtë libër, i cili përmbledh rreth 40 vjet shënime të autorit mbi dialektet shqiptare të Maqedonisë dhe mbi 20 mijë leksema, topoleksema e gjerdane fjalësh të urta.”⁷

Vepra *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, 2015, është misionare në rrugën dhe në përpjekjet shkencore për të mos lejuar këtë “vdekje gjuhësore” dhe autori ka bërë punë të madhe për ta mbledhur në një vepër / fjalor të vetëm punën e vet dhjetërvjeçare për fjalën e gjuhës së gjallë të popullit në hapësirën shqipfolëse maqedonase⁸. Fjalori shpërfaqet si

⁴ Q. Murati, *po aty*, f. 11-12.

⁵ Q. Murati, *po aty*, f. 12.

⁶ Q. Murati, *po aty*, f. 7.

⁷ Q. Murati, *po aty*, f. 7.

⁸ Sipas Q. Muratit, “Ky Fjalor është ribotim i plotësuar ndjeshëm i botimeve të mëparshme të autorit: *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë* (1998), *Fjalor i fjalëve*

një vepër me vlera të rëndësishme. Vetë Q. Murati shkruan se “kjo vepër e rrallë e leksikografisë shqiptare, me vlera të veçanta gjuhësore e etno-kulturore, do të sjellë mjaft lëndë të re dhe si e tillë do të jetë një mjet pune për këdo që do të merret me shqipen dhe gjuhët e tjera në kontakt të arealit ballkanik.”⁹

Megjithatë autori i veprës është më se i ndërgjegjshëm se puna e bërë nuk është kurorëzim përfundimtar i procesit të gjurmimit të fjalës në terren e i vjeljes së pasurisë leksikore nga botime të ndryshme, sepse siç e pohon me gojë e vet, “Ndonëse i konceptuar si fjalor thesar, që mëton të përfshijë gjithë pasurinë leksikore të ligjërimeve shqiptare të truallit të Maqedonisë, ky fjalor vetëm pjesërisht mund ta arrijë këtë synim, sepse vërtet pasuria leksikore është e pamatë dhe vështirë është të regjistrohet shterueshëm.”¹⁰

Titullimi i veprës *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni* të ngacmon, të jep shtysën për t’u ndalur “këmbëkryq” dhe me nge për të parë se ç’pasuri sjell ky fjalor, i cili sipas fjalëve të autorit leksikograf ka një frymëmarrje shumë të gjerë. Hartuesi i saj shkruan se “Projekti sjell korpuse të reja leksikore, frazeologjike e toponomastike me interes për gjuhën shqipe dhe për bashkëmarrëdhëniet e shqiptarëve me popullsitë sllavojugore maqedonase, turke, arumune etj. Në këtë thesaurus të gjuhës ndodhen unitetet përveçuese linguistike që disponojnë këto tërthore. Ky fjalor si i tillë nuk përbën vetëm një thesar të vërtetë të gjuhës shqipe, ky është si të thuash dhe një fjalor ballkanologjik, sepse aty përfshihet një korpus i përfillshëm edhe i elementeve greke, romane, sllave, turke, arumune etj. që kanë penetruar në këto të folme në shekuj e mijëvjeçarë. Me përmbajtjen që ka, ky Fjalor do t’u ofrojë studiuesve një lëndë të dorës së parë për hulumtime krahasimtare në gjuhët dhe fushat përkatëse: fonetike, morfologjike, leksikologjike, etimologjike, semantike, etnografike, onomastike etj.”¹¹

Studiuesja Sh. Islamaj, që vazhdueshëm, nga afër dhe me shumë kujdes shkencor, ka ndjekur punën e Q. Muratit në fushën e leksikografisë dialektore (madje e ka çuar atë te përdoruesi me oponenca të vlerësueshme) shkruan se “Leksiku i të folmeve që na paraqitet në Fjalorin tonë, u takon të dy dialekteve, ndonëse pjesa dërrmuese i shkon në favor dialektit gegë, dhe ai përfshin: dialektizma me shtrirje të gjerë, gjysmëdialektizma ose krahinorizma dhe në një pjesë të mirë fjalë të rralla, fjalë të panjohura në shkallë dialekti dhe njësi

të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë (2003), si dhe i korpuseve *Fjalor i sllavizmave në të folmet shqiptare të Maqedonisë* (2004), *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë* (2008).” Shih më gjerë Shih Q. Murati, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, Shkup, 2015.

⁹ Q. Murati, *po aty*, f. 7.

¹⁰ Q. Murati, *po aty*, f. 11.

¹¹ Q. Murati, *po aty*, f. 11.

leksikore me një shtrirje fare të ngushtë gjuhësore. Konsideroj se kjo është pjesa më e vlefshme e Fjalorit, dhe ajo zë një vend të mirë në këtë fjalor.”¹²

Lënda e sjellë në faqet e kësaj vepre, trupëzon punën e drejtpërdrejtë gjurmuese në terren (Q. Murati është një nga leksikografët më të identifikueshëm të terrenit në mbarë hapësirën shqipfolëse), si dhe punën vjelëse nga botime të llojeve të e tipologjive shkrimore të ndryshme. Edhe pse i cekëm shkarazi më lart burimet e kësaj lënde, po e ritheksojmë këtë karakteristikë përdalluese të punës së këtij shkencëtari përmes parashtrimeve të bërë nga vetë ai. Q. Murati na jep një informacion të hollësishëm për këto burime, kur shkruan se “Fjalësin e këtij Fjalori e kemi qëmtuar nga tërthoret gjeografike shqiptare: të rajonit të Kumanovës e të Likovës, në ultësirën dhe në Malin e Zi të Shkupit, në luginën e rrjedhës së Vardarit – në Derven, Tetovë, Gostivar, në luginën e Radikës – të Rekës së Epërme e në Dibër, në rajonin e Kërçovës, Krushevës, Prilepit dhe Velesit më në lindje (të tipit të gegërishtes), dhe në rajonin e Strugës (me disa fshatra të toskërishtes), të Ohrit, të Prespës dhe të Manastirit (të tipit të toskërishtes) më në jug. Materialin e kemi vjelë nga botime të ndryshme dialektologjike, folklorike, etnografike, si dhe duke dalë vetë në terren.”¹³

Por studiuesi Q. Murati, vetëdijshëm dhe me pikësynime të caktuara, duke ndihur në punën studimore (por jo vetëm atë studimore) e duke lehtësuar dukshëm shfrytëzimin e pasurisë leksikore të qëmtuar në trojet shqiptare të Maqedonisë, ka përfshirë në veprën *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të shqipes së Maqedonisë* edhe prurje të autorëve të tjerë, me ndihmesa të çmuara në leksikografinë dialektore me lëndë nga këto areale gjuhësore. Ai shkruan në **Parathënien / Preambulën** e veprës se “Po kështu, kemi shfrytëzuar dhe materialin e vjelë nga një ekspeditë hulumtuese në fshatrat Nerez, Krushopek, Bukoviq, Çajlanë, Gllumovë të Shkupit (realizuar nga Xhabir Ahmeti, Rini Useini, Agron Salih dhe Ganimete Ramadani, nga data 22 korrik – 13 gusht 2008). Në fondin leksikor të këtij Fjalori kemi shtënë edhe fjalë nga të autorëve të vjetër të fjalorëve të Pulevskit (për Rekën e Epërme) dhe të Qiriazit (për trevën e Manastirit).”¹⁴

Më poshtë po ndalemi drejtpërdrejt në nxjerrjen në pah të prurjeve të veprës, të ilustruar gjerësisht (me mëtim të qartë e me bindje) me lëndë leksikografike, onomastike, toponomastike, etno-lingustike etj.

A. Fjalori mbart **një pasuri të madhe leksikore**, që duhet çmuar për vlerat e shumta shënuese e shprehëse që ajo i sjell fondit të fjalëve të regjistruara deri tani në shqipe.

¹² Q. Murati, *po aty*, f. 817.

¹³ Q. Murati, *po aty*, f. 7-8.

¹⁴ Q. Murati, *po aty*, f. 8.

a.1. Për ta pohuar këtë tregues, po ndalemi vetëm në dy shtresa të mëdha fjalësh:

a.1.1. Leksikografi Q. Murati ka pasqyruar në *Fjalor* një numër shumë të madh njësisish që lidhen me **leksikon konkret**. Është krejt e natyrshme se gjurmuesi i fjalës në terren gjurmon dhe kërkon të regjistrojë, patjetër e së pari, emërtimet e sendeve që lidhen me botën materiale të banorëve të arealit gjuhësor ku organizohet apo kryhet ky gjurmim, që lidhen me botën e tyre të ushqyerit, me botën e veshjeve, me botën e bimëve e të kafshëve të kësaj hapësire ku ata jetojnë, me botën e zejeve e të ndërtimtarisë etj. Ne po sjellim për ilustrim, disa njësi që nuk janë zgjedhur se kanë thjesht vlerë identifikuese, por edhe për të tërhequr vëmendjen e shumëkujt e sidomos të gjuhëtarëve (të vjetër apo të rinj qofshin) se këto njësi e mijëra të tjera duhen ta shtrijnë hapësirën e përdorimit, duke u bërë pronë e shqipes standarde¹⁵:

Bróçk/ë, -a *f.* kalliri i misrit pa kokrra, lëvozhgë, lëvore, sin. *çkutka, kalláshtra* (Strim., RE).

Brúj/ë, -a *f.* lym, tallabak (Str. T.). *Najlók* (Shu.). *Kumsáll* (Fr.).

Brinór *mb.* ka me brirë të mëdhenj (Str.).

Bukán/e, -ja *f.* dele e madhe, e rëndë në të ecur, e plogësht (MT.).

Ithërník, -u *m.* lloj lakrori që përgatitet me dy shtresa petësh dhe me hithra të ziera (Pre.).

Ithton *fol.* thuhet për gjellën kur është e athët, kur digjet paksa (Kër.).

a.1.2. Por autori i Fjalorit ka meritën se ka gjurmuar dhe qëmtuar një numër jo të paktë njësisish leksikore, që i përkasin leksikut abstrakt, me synimin edhe për ta hedhur edhe atë gjerësisht në përdorim për folësit e mbarë shqipes. Po japim për ilustrim:

Bubuzhój *fol.* grafulloj në të thartë, fermentoj (Reç.).

Bubuzhón *fol.* fermentohet duke shkumëzuar e duke shtuar vëllimin (Gos.).

¹⁵ Të gjitha ilustrimet janë marrë nga Fjalori në mënyrë mekanike, pa asnjë ndryshim. Ndaj lexuesi i artikullit nuk mund të diskutojë e paragjykojë çështje që mund të lidhen me ndonjë pasaktësi që mund të jetë rrjedhojë e ngutshmërisë së hartuesit për një botim sa më të shpejtë të veprës. Kështu njësitë **Brinór** *mb.* ka me brirë të mëdhenj (Str.); **Brinóre** *mb.* lopë me brirë të mëdhenj (Str.). **Sykajname** *mb.* vajzë a nuse e bukur që i ka sytë si kajnak, burim uji (RE), janë dhënë si mbiemra, por shpjegimi është bërë për secilën si të jenë emra (shpjegimet duhet të fillonin me përemrin lidhor *që* dhe jo me emër: *që ka brirë të mëdhenj, që i ka sytë të bukur si kajnak* etj. Ose kuptohet që njësia **Bukank/ë, -a** *m.* dele me lesh të ashpër dhe të bardhë (MT), nuk mund të jetë e gjinisë mashkullore, edhe pse është dhënë me elementin *m.* (mashkullore). Duket i njësisë që është lapsus shpejtësie / nxitimi, sepse vetë shpjegimi me fjalën *dele* (e jo me fjalën *dash*) tregon se emri është i gjinisë femërore.

Bucállkë *mb.* ngucakeq, ai që ngucet me fjalë e me dorë (Kër.). *Buckác* (P., Dib.). *Búcko* (Gos.).

Jermsh *mb.* njeri që flet përgjumshëm (Ra., Çaj., Buk.).

Kreythátë *mb. fig.* njeri jo i zoti (Kër.).

a.1.3. **Emërtimet e pathjeshta** janë një tjetër pasuri e regjistruar dhe e pasqyruar në faqet e veprës. Madje grupi paradigmantik i këtyre emërtimeve tregon edhe një herë pasurinë e madhe gjuhësore të shqiptarëve, aftësinë e tyre për të krijuar një emërtim mbi një tregues mjedisor, kohor, funksionor etj. të bimëve, të kafshëve, të ngjarjeve familjare, historike etj. Kjo pasuri përmes Fjalorit, jo vetëm hidhet në një përdorim të gjerë (jashtë hapësirës së ngushtë ku është gjetur), por ajo është një fushë interesante studimore për të studiuesit e rinj, për të parë izoglosinë e përdorimeve dhe për ta përqasur me botimet e tjera shkencore në gjuhën shqipe, f.v., me pasurinë e emërtimeve nga bota bimore dhe shtazore që gjuhëtari Xh. Lloshi ka përfshirë në veprat *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht dhe latinisht-shqip* (Albanian-Latin and Latin-Albanian Dictionary of Plant and Animal Names) dhe *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve anglisht-shqip dhe shqip-latinisht-anglisht* (English-Albanian and Albanian-Latin-English Dictionary of Plant and Animal Names)¹⁶.

Po ilustruam më tej me disa njësi që lidhen së shumti me botën bimore të trojeve shqipfolëse në Maqedoninë e Veriut dhe që kanë rëndësi shumë të madhe si në rrafshin emërtues, por dhe në atë të ndjekjes së linjës së motivimit të brendshëm:

Bari përfolës *bot.* një lloj bari që u jepej me kripë dhenve Ditën e Shëngjergjit (MT).

Bari vérdhë *bot.* lloj bari i keq që e prish jonxhën, e zverdh (Kr.).

Çaj zemre *bot.* lloj barishteje e ngjashme me tërfonjën, që rritet nëpër vende malore. Përdoret si çaj kundër sëmundjeve të zemrës (Kër.).

Krahóni égër *bot.* lloj bime që rritet nëpër plehra të shtëpive, me kërcell të gjatë e të degëzuar, me gjethe të gjera e të dhëmbëzuara e me lule të bardha. Jep njëfarë fryti të rrumbullakët gjembor, me të cilin fëmijët krehin flokët (Tuh.).

Lule shkëjne *bot.* lule që çel në verë, me ngjyrë të theksuar dhe aromë të këndshme – *Orchis morio* (Kër.). *Lule shkine* (Kr.). *Lule shkëjne* (Kor.).

Lule shúrdha *bot.* rrënjët e kësaj bime përdoren kundër çrregullimeve të mëlçisë së zezë, tëmthit, nxit oreksin etj. (Zag.).

¹⁶ Shih për këtë Xh. Lloshi, *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht dhe latinisht-shqip* (Albanian-Latin and Latin-Albanian Dictionary of Plant and Animal Names). Logos-A, Shkup, 2010; Xh. Lloshi, *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve anglisht-shqip dhe shqip-latinisht-anglisht* (English-Albanian and Albanian-Latin-English Dictionary of Plant and Animal Names), Logos-A, Shkup, 2014.

Mollë magjári bot. lloj kaktusi, ferrë me fryt të rrumbullakët, të cilën e ha shumë gomari (RE.).

Mollë óuku bot. 1. bythëqiqër, mollë ujku (Tuh.). 2. mollë e egër me shije të thartë (Zhit.).

Rróush gjuri bot. barishte që u jepej kafshëve Ditën e Verës, përzier me kripë dhe i fryrë nga ndonjë besimtar (Rog., Der.).

Rróush mace bot. lloj barishteje që përdorej për të përtërirë farën e kosit (PE.).

Rróush temjáni bot. lloj rrushi i zi me aromë temjani (Le.).

Zemër cuce f. bot. lloj lule shumëvjeçare me ngjyrë të bardhë në sheqerlie me katër petale më të gjera në formë të zemrës dhe dy më të ngushta, me gjethe të gjelbra të theksuar dhe të lëmuara. Rritet në saksii, zakonisht kultivohet brenda në dhomë apo në ballkon. *Do të më japësh një (lule) zemër cuce?* (Str.T.).

a.1.4. Në Fjalor krejt natyrshëm, kanë zënë vend me qindra **eufemizma**. Po japim sa për ilustrim:

Kafsh/ë, -a f. e hasim vetëm në mallkimet *Kafsha e keçe. Kafsha e ligë*, në kuptimin kafshë e egër (bishë) ose sipas besëtytnive shpirt i keq. *T'hangtë kafsha e keçe!*. *Të hangtë kafsha e ligë*, mallkojnë njerëzit në këtë anë dikë që nuk sillet mirë a bën ndonjë prapështi. Fjala *kafshë* për qenie të gjalla, si lopë, dele etj. është zëvendësuar plotësisht me fjalën e huaj *hajvan*. Kjo shprehje dëshmon se fjala *kafshë* në këtë anë është kurrur deri në zhdukje para fjalës orientale *hajvan* (Kum.).

a.1.5. *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni* përdallon edhe pasqyrimin e kuptime të reja. Po japim këtu tri zëra leksikorë që kanë një formë fonetike “**sherrét**” [katër zëra leksikorë, në qoftë se përfshijmë këtu edhe zërin “**Sherét** mb. i mençur (Tet., Gos.)”, që së shumti është një variant fonetik i fjalës **sherret**] që dalin në marrëdhënie enatiosemie (në marrëdhënie antonimike të brendshme) me njëri-tjetrin. Pra autori sjellë krahas kuptimit “**sherrét,-e** – që bën sherr”, edhe kuptimin “**Sherrét** – që është i mençur”. Këto 4 njësi leksikore mund të ishin përfshirë në vepër në një zë të vetëm leksikografik, duke bërë një strukturim me 2 kuptime. Madje edhe shpjegimi duhej të bëhej me tipologjinë atributive, sepse janë shenjuar si mbiemra, ndërsa janë shpjeguar si emra:

Sherret mb. djalë a burrë i mençur (Kër.).

Sherret mb. njeri me sherr (MSHT).

Sherrete mb. vajzë grua e mençur (Kër.).

a.2. Vepra, ndër të tjera, të tërheq vëmendjen dhe për pasqyrimin të gjerë e të saktë të **relacioneve të ndryshme semantike**. Do të veçonim këtu punën e madhe që ka bërë autori për të ndjekur me profesionalizëm dhe për të sjellë pasuri të vyer që lidhet me disa nga këto lloj marrëdhëniesh:

a.2.1. **Polisemia**, është një dukuri e ndeshur shpesh në lëndën që ka zënë vend në Fjalor. Fjalët me dy kuptime ndeshen shpesh, por nuk mungojnë dhe ato me tri, katër apo edhe më tepër kuptime.

Árk/ë, -a f. sh. –**a, -at**. 1. barrë. 2. çejz, pajë. *Të hanën çojmë arkat* (M.). **Cínxull, -i** m. gjinkallë, 2. i vogël, i lig, i keq (Pre.).

Labiç, -i m. qen i vogël rrugësh. 2. fig. i thuhet dikujt për ta fyer a me përkëdheli. *Labiç i keq* (Kër.). E shënon dhe G. Majeri në *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe* (2007, 274) me kuptimin “lugat”.

Bishták, -u m. sh. –**ë, -ët**. 1. guralec me të cilin luajnë njëfarë loje të quajtur me të njëjtin emër. 2. ndajf. loja me guralecë (Kër.). *Gjúrës* (MT., Bo.). *Bështash* (Str.).

Búç/e, -ja f. 1. viç i vogël; 2. ka i madh me brirë të shkurtër e me kokë madhe (MT.).

Jeshiljagurí bot. 1. bar i gjelbër. 2. barkqitje. 3. fig. njeri i papjekur. 4. bostan i papjekur. *Mo e shkit se o jeshiljaguri* (P.).

Jeshilt (i, e) mb. i gjelbër. *Fanellj`e jeshilt. Ondrra t`jeshilta*. 2. fig. Njeri i papjekur, fruti i papjekur. *Ka met jeshil – ka mbetur i papjekur. Koungëll jeshil* (Kër.).

a.2.2. Një dukuri tjetër semantike që ka zënë vend në Fjalor është **sinonimia**. Autori ka dhënë me qindra e qindra njësi që hyjnë në marrëdhënie afrie apo barasvlerësie, duke e shfrytëzuar ndjeshëm këtë kategori semantike me frytshmëri për shpjegimet kuptimore të njëjësive leksikore dialektore apo krahinore, që janë pak të njohura ose aspak të njohura. Po ilustrojmë:

Bugërdár, -i m. kaçamak, përvëlak, bakërdar (RE.). *Bakërdó* (Kr.).

Kabéc, -i m. petrit, skifter. *M`i hangri pulat kabeci* (RE.). *Kubéc* (Tet.). *Huti-ni* (Kër.).

Kabrane f. def, dajre, daulle (Gr.).

Tekaté ndajf. veças, ndaras. *Hanë tekatek* (Kër., Dob.).

a.2.3. Interesante është ndjekja e dukurisë **së homonimisë** në këtë Fjalor. Autori ka dhënë me dhjetëra çifte homonimike, por ky numër mund të shtohet ndjeshëm në një ripunim e botim tjetër të veprës, sepse shumë njësi kanë përputhje fonetike, kanë përkatësi leksiko-gramatikore të njëjtë, por kanë kuptime të ndryshme e që nuk janë shenjuar si homonime¹⁷.

Báč, -i m. stanar. *Gjath baçi* djathë i fortë që përgatitet në bjeshkë (Der., Dib., Dob.).

Báč, -i m. II spagë e lehtë me të cilën mbanin brekët. *Baçi brekve* (Kër.).

¹⁷ Edhe paraqitja leksikografike e homonimisë në vepër kërkonte një kujdes dhe më të madh dhe punë korrektuese më të mirë. Në shumë njësi që hyjnë në marrëdhënie homonimike, shenjohet (markohet) me shifër romake (I, II, III etj.) si homonim gjymtyra e dytë (dhe e treta, nëse ka), por kjo nuk bëhet me të parën. Të tre shembujt e sjellë për ilustrim e tregojnë këtë.

Baç, -i m. III mjet për të zënë djathin (RE).

Bál/e, -ja f. grua shtëpiake, që është punëtore e mirë (Pre.).

Bále, -ja f. II lopë me pulla të bardha në trup (Pre., Gur.).

Búlk/ë, -a f. lloj frizure, balluke (Tre., Kër.).

Búlk/ë,- a f. II dele leshatore (Str.).

a.3. Qemal Murati ka bërë një punë të lavdërueshme për të sjellë edhe **jetën e fjalës**, me ilustrime të regjistruara drejtpërdrejt nga goja e subjekteve folëse, por edhe me ilustrime nga folklori, letërsia etj. Kjo është tejet e rëndësishme, sepse përmes kësaj jete përcaktohet kuptimi (nuanca kuptimore e njësisë etj.), shihet sintaksa popullore dhe lidhjet sintagmatike që vendos fjala e ilustruar. Ajo dhe është mëse e domosdoshme për të përcaktuar edhe kategorinë leksiko-gramatikore të njësive të regjistruara, në rastet kur ka ambiguitet semantik etj. etj. Po japim ndonjë shembull me ilustrime të ndryshme:

Aset m. zili, smirë: *Mos dërgjo moj syzeza se ç`folin mileti/ Folin nga inati, edhe nga aseti* (Këngë popullore, Zagraçan). *Hypa në një degë ulice/ Pashë një moj, të bukurë/ Lark e pash` asset ju bora / Më pikoj allah në zemër* (La.). Lakmi (Dib.).

Rropat/ë, -a f. sh. -a, -at. 1. zhurmë e madhe, rropamë. *U bo një rropatë e modhe* (Kër.). 2. të sharat, qortime. *De t`i hanje rropatat oun* (Kër.).

Rropatat sh. fjalë qortuese, të sharat. *Aj i ka hongër rropatat* (Kër.).

Rropocák mb. rrapashqyt, shulak. *O more rropocak / lavde shoum e deri pak*, kp. (Tet.).

Rrós/ë, -a f. jetë. *Ka bo rrosë të meir* (Kër.).

Rroskomóle, -t f. kryes.sh. gjëra të tepërta, e si të pavlera. *Ka bo xhyth ato rroskomole, e nuk i pagju borxhet. Ç`ke vesh xhyth këta rroskomole* (Kër.).

Seféré f. vjet. udhë, rrugë. *Tranafil qofsh i errë / ce ke dalë nër at ferrë / sën të houlem të t`morr erë / se jem nejs për seferë*, kp. (Kër.).

Selísht/ë, -a f. sh. -a, -at. kopsht i i mbjellë me pemë pranë shtëpisë (Pre., Str.). *Shtëpitë e zenginit me selishta pranë / i nderuar qoftë nëna me babanë / që më dhanë bejçen ku kisha sevdanë*, kp. (Str.).

Shenxhie mb. vajzë a grua e hareshme, me shen: *Vet e kimi pa to mejrën tu maroe oja/ Ishte shaum shenxhije e mejra, shaum i çeshte goja! Vet e kimi pa to mejrën do rejte te muri? Ishte shaum shenxhije lulja, shaum i çeshte nuri!* (MSHT).

Tërllaçk/ë, -a f. 1. ashkël. Copat që dalin nga druri i gdhendur. *Sa tërllaçka paskan bërë këtu. Po, mor, tërllaçkat janë të thata. S' paska asnjë tërllaçkë këtu. Merr ca tërllaçka për ta ndezur zjarrin* Str.T.). 2. dru krejtësisht i kalbur (Kër.).

B. Pjesë e qenësishme e veprës *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, është dhe kreu i emërtuar **Fjalor frazeologjik**, ku janë përfshirë rreth 1.200 njësi frazeologjike, një pasuri e vyer edhe kjo, që sendërton përsëri profesionalizmin e autorit, duke ditur edhe vështirësitë që

dalin gjatë gjurmimit të saj. Sipas hartuesit Q. Muratit, “Frazeologjia dialektore e këtyre të folmeve, e krijuar brez pas brezi nga populli, ka petkun e saj të mëvetësishëm shqiptar, sepse është e lidhur me situata të posaçme dhe motivohet me ngjarje konkrete historike ose episodike të këtyre tërthoreve gjeografike. Shumë njësi frazeologjike të këtij visi mund ta pasurojnë fjalorin e frazeologjisë shqiptare, të tilla si: *Iku nga prushi e ra në gaca; Ka gjet katund pa qen; Lyp pushkë në gajtan të tirqve; Mos ia dëfto katundarit punët e katundit; Murrizin e bën kungull; Nuk të shkon parmenda në këtë brazdë; S’të jep një pordhë hua “është shumë koprrac”; Ta bën pojatën kullë bajraktari “është mikpritës” etj.*”¹⁸

Në vijim po japim një lagje të vogël njësisish frazeologjike, që motivohen semantikisht me fjalën **Kalë**:

T’kërkoj me komë kali – të kërkoj kudo shumë larg, edhe atje ku njeriu nuk mund të mbërrijë, atje ku mund të shkohet vetëm me kalë. (Ve.).

Houpet kali me shalë – thuhet për ndonjë rrëmujë të madhe, ku s’merret vesh asgjë (Kër.). *Humbet kau me gjithë viç* (Berat).

I ka hyp kalit t’zi – është prapësuar, ka marrë prapë (Gos.).

Kalë i azdisur – djalë a burrë pa fre, i papërmbajtur, që bën si do vetë (Pre.).

Kalë i ngordhur – njeri i dobët e i pafuqishëm, që ka marrë fund e s’ka ç’bën (Pre.).

Shkojsh me kalë, kthehesh me gomar – kur s’ecën pazari mirë (Sll.).¹⁹

Përveç njësive frazeologjike që janë përfshirë në këtë pjesë të Fjalorit, mund të hasësh me dhjetëra të tilla edhe në lëndën që markohet si fjalor leksikor. Ndaj numri 1.200 mund të shtohet natyrshëm edhe me shumë njësi të shpërndara në vepër.

Bëj tarxhis fol. mërzis dikë. *Y bëra tarxhis* (Ma.).

Mizë móshkëll fig. ai që s’punon fare, që përfiton nga puna e të tjerëve. *Rrejn si mizë moshkëll* (Kër.).

Shkinë Poreçe mb. shprehje keqësuese për gruan (Cërn.). Sipas krahinës së Poreçes, të banuar me popullsi sllavomaqedonase.

Shkop xhípi fig. njeri që rri si shkop dhe s’punon asgjë (Tet.). *Shkop xhýpke* (Kr.).

C. Leksikografi Qemal Murati e ka parë të arsyeshme që, si pjesë përbërëse të veprës *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, të japë dhe **Fjalorin e turqizmave** (Turqizmat (orientalizmat). Parë nga jashtë, kjo është përsëri një prurje tjetër që duhet vlerësuar e veprës për të cilën po shkruajmë. Autori e lehtëson, kështu, ndjeshëm përdorimin e fjalorit,

¹⁸ Q. Murati, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, Shkup, 2015, f. 283.

¹⁹ Q. Murati, *po aty*, f. 365.

lehtëson gjithashtu dhe çdo sipërmarrje në studimin e kësaj shtrese fjalësh në të folmet shqiptare të Maqedonisë së Veriut.

c.1. Së pari, kjo pjesë e veprës duhet vlerësuar se ajo pasqyron një punë të jashtëzakonshme që autori ka bërë për të regjistruar turqizmat në këto hapësira. Fjalor mbart mbi 3.300 njësi të tilla, një numër ky relativisht i lartë i huazimeve në të folmet dialektore²⁰. Por ato janë një fakt gjuhësor dhe ndihmojnë ndjeshëm studiuesit për të sipërmarrë studime serioze, duke bërë analiza e përcaktime të sakta shkencore se cilat prej tyre janë huazime të vërteta (duke i dalluar nga kuazihuazimet të tipit **zптоj** që është formuar në shqip nga orientalizmi **zap**), cilat prej tyre janë huazime të ngulitura, cilat i takojnë leksikut aktiv e cilat leksikut pasiv, cilat i përkasin një areali të ngushtë gjuhësor e cilat lidhen me botën bashkëkohore të gjithë shqiptarëve (për të parë mundësitë e shtrirjes apo të kufizimit /mënjanimit të tyre) etj.

Q. Murati shkruan për këtë shtresë huazimesh: “Shumica e fjalëve turke që kemi qëmtuar nga të folmet shqiptare të Maqedonisë dhe i kemi evidentuar në këtë Fjalor, i takojnë kryesisht fondit të arkaizmave, kanë mbetur si kujtim dhe përdoren zakonisht nga brezi më i vjetër; brezi i ri i përdor më rrallë dhe i ka zëvendësuar me fjalë të tjera shqipe ose të huaja. Orientalizmat leksikore që kanë hyrë prej kohësh në ligjërimet shqiptare të Maqedonisë i kemi qëmtuar nëpër botime të ndryshme leksikografike, folklorike, si dhe nga goja e gjallë e popullit. Një numër të mirë të tyre, që janë më frekuentuese e me përdorim më të përgjithshëm për mbarë shqipen, nuk i kemi evidentuar për çdo të folme veç e veç, kur ato nuk paraqesin veçori dalluese fonetike dhe semantike, si p.sh. fjalët *amin, bajram, bahçe, bunar, çatall, gajle, çorbë, dert, fukara, gjok, hallall, ilaç, jahni, jelek, odë, sabah, saç, okë, soj, tallaz, etj.*”²¹

Dhe vazhdon më tej duke theksuar qëllimin e punës: “Elementet kulturore orientale të shqiptarët e Maqedonisë janë në zhdukje e sipër përballë sfidave të reja globalizuese. Leksiku oriental ka marrë gjithashtu rrugën e bjerrjes përballë fjalorit të anglishtes dhe të gjuhëve të tjera euro-perëndimore. Në këtë kuadër, ndërmarrja jonë për të hartuar një fjalor të orientalizmeve në të folmet shqiptare të Maqedonisë është një përpjekje e vogël për të konservuar dhe për të shpëtuar diçka nga ajo pasuri e madhe gjuhësore e kulturore e botës orientale, që rron sot e gjallë te brezi më i moshuar.”²²

²⁰ Studiuesi / leksikografi Q. Murati e orienton përdoruesin e Fjalorit që në krye të këtij kreu (pjesë) për këtë gjendje gjuhësore. Ai citon Petar Skokun, i cili shkruante 80 vjet më parë se “*Një nga karakteristikat kryesore të gjuhëve ballkanike është numri i madh i fjalëve me prejardhje turke, persiane dhe arabe. Fjalët orientale në gjuhët ballkanike janë aq të shumta sa kapërcejnë çdo element tjetër*”. Petar Skok (Përpjekja Shqiptare, 14-15, 1938). Shih për këtë Q. Murati, *po aty*, f. 437.

²¹ Q. Murati, *po aty*, f. 437.

²² Q. Murati, *po aty*, f. 437.

Po japim nga Fjalori një numër jo të vogël nga këto njësi:

Ibadet, -i *m.* detyrë, obligim. *Pouna osht ibadet* (Dib.). Lutje fetare drejtuar zotit (Der.).

Idar/e, -ja *f.* ekonomizim, furnizim me gjëra të nevojshme për ekzistencë (Der.). *Me ajllëkun qi mer boet idare* (Dib.). *Mezi bëheshin idare* – mezi siguronin bukën deri në të korrat e ardhshme (La.). Pasuria që është e mjaftueshme vetëm për ekzistencë. *Punojmë sa për idare* (PK).

Idaré, -ja *f.* pasuri që mjafton vetëm për të mbetur gjallë (Pre., Ma.).

Ifk/ë, -a *f.* homle (Strim.).

Iftibar, -i *m.* respekt, nderim, autoritet (Dib., PK).

Iftijaç *mb.* nevojtar. *Aj osht iftijaç i jot* (Strim.).

Iftirâ, -ja *f.* shpifje, e paqenë. *Mos fug iftira* (Strim.).

Igball, -i *m.* fat (Dib.). *T'i lutna Zotit t'na çelin igballin* (EPSH).

Igdil, -i *m.* rrugë. *Se igdilin e ka larg/ Larg e larg tre sahat* (EPSH).

c.2. Në vepër janë përfshirë dhe një numër i vogël **njësish frazeologjike** të motivuara nga një fjalë turke (autori i ka emërtuar *Fraza idiomatike me elemente të turqishtes*):

E mba umuti – shpreson (Tet.).

E ka çit në tellall – i ka bërë jehonë të madhe (Kër.).

Ep selam e del borxhli (Der.).

Ejp selom e xhi belanë – t'i bësh një të mirë dikujt, e të të kthehet me të keq (Kër.).

c.2.3. Në këtë pjesë janë dhënë një grup me **topoleksema** me burim prej turqishtes (153 njësi). Këtu duhet të themi se autori sjell lëndë të begatë toponimesh në formë frazemash (me më shumë se një gjymtyrë). Njëra nga këto gjymtyrë mund të mos jetë patjetër toponim / apo emërtim me burim turk.

Bunaret e Lopfe – puse ku u japin ujë lopëve të fshatit (Gu.).

Bunaret e Maskishes – burime uji, puse (Gu.).

Çarshia Epërme – vend ku bëhet pazari në Tetovë.

Çarshia Poshtme – vend pazari (Tet.).

Derveni Epërm – mal i thatë (Gu.).

Derveni Poshtëm – mal, grykë (Gu.).

c.4. Por autori i Fjalorit e ka parë të arsyeshme të japë dhe një listë tepër të redaktuar **me emra vetjakë femërorë** dhe **mashkullorë** me burim nga turqishtja ose të hyrë në shqipen e Maqedonisë së Veriut përmes turqishtes. Po japim disa syresh:

Arifka (Gurgurnicë, Tetovë).

Elmaska (Gurgurnicë, Tetovë).

Gjylnaze (Dobërcë, Tetovë).

Meleke (Sellcë e Keqe, Tetovë).

Nebije (Jellovjan, Tetovë).

Shefqete (Lisec, Tetovë).

Junus (Cërnilishte, Prilep).

Vexhi (Strimnicë, Tetovë).

D. Në veprën *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, Qemal Murati ka nxjerrë si kre më vete edhe shtresën e huazimeve sllave në këto troje, duke e titulluar atë “**Fjalor i sllavizmave në shqipen e arealit të Maqedonisë**”. Vetë ai shkruan se “ka munguar një fjalor i cili do të inventarizonte gjithë fondin e sllavizmave dialektore në të folmet tona në vështrim, ku do të përveçohet ç’është sllave në fjalësin e këtyre të folmeve e çka nuk është sllave”²³. Vetë ky pohim që duket si mëtim pune, por që është dhe kryerje / realizim i saj tregon orientimin e qartë të kësaj pune. Duke u marrë gjithë jetën me shqipen e fjalën e saj, duke e njohur nga afër pasurinë e gjuhës amtare, por njëherazi duke njohur edhe serbokroatishten, e maqedonishten (si dhe me një formim të mirë në marrëdhëniet e shqipes me gjuhët sllave), ai ashtu si dhe te paraqitja e huazimeve turke në arealin gjuhësor të shqipes truallsore në Maqedoninë e Veriut, edhe këtu sjellë një lëndë me interes studimor, por edhe për përdoruesin e shqipes në komunikim. Qemal Murati jep një informacion telegrafik që në hyrje të kreut dhe shkruan se “Fjalësi i sllavizmave në të folmet shqiptare të Maqedonisë, prej 1140 leksemash, së bashku me topoleksemat sllave të këtij visi në arealet shqiptare (205), dhe njësitë idiomatike paralele të këtyre dy gjuhëve (945), përbëjnë një pasuri gjuhësore me interesa shumëplanëshe për albanologjinë, për maqedonistikën dhe për ballkanologjinë.”²⁴

Autori i Fjalorit ka krijuar dhe një term ad hoc për këto lloj huazimesh. Ai shkruan se “Sllavizmat e këtyre të folmeve, të cilat mund t’i quajmë me një term më të përshtatshëm shkencor *sllavomaqedonizma* apo *sllavizma maqedonase* kanë karakter krahinor a dialektor; me format dhe me përdorimet e tyre ndryshojnë nga njëra e folme tek tjetra, madje dhe brenda vetë një regjioni të caktuar.”²⁵

Dhe më tej ai ndalet në dukurinë e “konkurrencës” leksikore në një mjedis dygjuhësie, **fjalë shqipe / sllavomaqedonizëm**. Ai, përmes ilustrimeve, jep dukuri të kësaj gjendjeje. Dhe më tej shkruan se “Për një karakter të tillë të sllavomaqedonizmave flet dhe përdorimi i tyre bashkë me çiftet sinonimike leksikore të shqipes, pra përdorimi paralel i huazimeve sllave dhe i fjalëve të fondit vetjak, si p.sh.: *zhabë – bretkosë, lesnaik – xheth dushku, zollvë – kunatë, përzhiti – fërgoj, peçurkë – këpurdhë, shtrek – lelek, pitaç – lipsak, zdravaitet – mëkomet, sakicë – sopatë, përviçe – spari herë, tërllë – vathë, bërslik – vaith, jazovec – vedëll, razboj - vek* (Derven, R. Nesimi, 387); sllave-turke: *leskë – tezgere, kollcë – takërlek, odbor – aza, bollneicë – astahone*

²³ Q. Murati, *po aty*, f. 573.

²⁴ Q. Murati, *po aty*, f. 479.

²⁵ Q. Murati, *po aty*, f. 479.

(Derven); *skutaçe* – *peshterkë* (Kërçovë) etj. Një numër i mirë i maqedonizmave dalin të përdoren si dublete edhe në disa të folme të tjera shqipe: *bres/ breslik* (përdoret edhe *vaidh*), *datelinë* (edhe tërfonjë), *mraz* (edhe *ngrij*), *munjon* (edhe *gjëmon*), etj.²⁶

d.1. Më poshtë po japim një lagje të vogël sllavizmash, pa u ndalur në fusha të caktuara tematike:

Bellçe *f.* Lopë e bardhë (MZSHK): maq. *belče*.

Bellço, -ua *m.* 1. Kafshë shtëpiake me ngjyrë të bardhë (kalë, ka, qen). 2. Fig. Njeri me ngjyrë të bardhë (Pre., Ma., MZSHK, Str.); *Biellço* (P.): maq. *belčo*.

Belk/ë, -a *f.* Dele e bardhë (Kër., P., Dib., Gos., Tet., Kum.); *Beckë* (Ma.): maq. *Belka*.

Bellushk/ë, -a *f.* Lopë ose dele e bardhë (P., Kr., Ka.): maq. *beluška*.

Bellushnic/ë, -a *f.* Lloj rrjete për gjuajtjen e bellvicave (Pre., Oh., Str.): maq. dial. *belušnica*.

Bren/ë, -a *f.* Trinë për të shtypur plisa, shqezë, brezë (Kër., Kr., P., Str., Strim., Dib., Gos., Shk); Branë (Pre., Ma.); *Brenë* (MSHT): maq. *brana*.

Drag, -u *m.* 1. Shkop i gjatë, me të cilin shkundin pemët që nuk mund të mbërrihen me dorë. 2. Fig. Njeri me trup të gjatë (Kër.): Sa *ni drag u boka* (P., Kr.); *Drong* (RE.); *Drang* (Poll.): sllvj. *drog* “dru, tra, dyrek”.

Dragan *mb.* Njeri me trup të gjatë: *Gjith ai dragan u boka* (Cërn.); *Dragell* (Kër.): sll. *drag*.

d.2. Me shumë interes studimor gjuhësor, por edhe etno-kulturor në Fjalor është dhe sythi “**Sllavizma të shqipes që mungojnë te vetë maqedonishtja**”, ku autori ndër të tjera pohon se “disa leksema janë krijime të brendshme të të folmeve shqiptare të Maqedonisë ose ruajtje mbeturinore prej brumit gjuhësor të sllavishtes, ngaqë ato mungojnë në të folmet përkatëse slave...”²⁷.

Edhe këtu po veçojmë disa syresh:

Bllago 1. “lloj ëmbëlsire si bakllava. 2. Gosti”, fjalë që me këto kuptime mungon në maqedonishten.

Drag/ë, -a *f.* grumbull bore që këputet nga mali, ortek, shvalinë, reshme (RE.). Burimin e kësaj fjale Çabej (SGJ I 136) e sheh të dalë nga sllavishtja jugore *draga*, baza e së cilës ka humbur në këto gjuhë, por del të ruhet në sllovenishten *sodraga, sodrag, sodrga* “breshërimë, topa bore të ngrirë”. Maq. *lavina*.

Prekár *mb.* keq. njeri i shëmtuar, me tipare të këqija (Kër.).

Prekarkë *mb.* keq. grua me tipare të këqija. *Prekark’e keçe* (Kër.).

Vojvodë *mb.* “Epitet që i jepet nuses kur përshkruhet bukuria e saj”, etj.

Zapovet *fig.* dhëndër, në kuptimin e figurshëm të urdhërdhënësit. Përdoret

²⁶ Q. Murati, *po aty*, f. 481.

²⁷ Q. Murati, *po aty*, f. 481.

figurshëm në këngë folklorike: *N`e ke hatër zapovetin/ Nuse unjesh pagës* (Këngë dasme II, Veleshtë, Strugë): maq. *zapoved* “urdhër”.

E. Q. Murati, ka bërë një punë lavdëruese për të paraqitur **karakterin dhënës të shqipes** në maqedonishte. Në Kreun V, “**Fjalor i albanizmave në maqedonishten**” ai shkruan se “Albanizmat leksikore në gjuhën dialektore të maqedonishtes, si rezultat i kontakteve shumë të gjata shekullore të shqiptarëve dhe të maqedonasve në hapësira të përbashkëta gjeografike, nuk kufizohen vetëm në një listë a numër të vogël fjalësh, siç janë shprehur më parë kështu disa studiues të maqedonistikës e të sllavistikës (A. Brückner, B. Koneski, B. Vidoeski, T. Stamatovski, P. Ilievski etj.), porse këto përfshijnë një koleksion mjaft të madh të tyre prej rreth 600 fjalësh e topleksemash në të gjitha fushat e fjalësit të maqedonishtes.”²⁸ Në parashtrimin e shkurtër studimor për këtë shtresë leksikore autori i Fjalorit thekson mënyrën e depërtimit të këtyre huazimeve në maqedonishte. Ai shkruan se “Albanizmat leksikore në të folmet dialektore të maqedonishtes kanë depërtuar kryesisht me rrugë të drejtpërdrejtë prej të dy kryedialekteve të shqipes – gegërishtes (së mesme) e toskërishtes (veriore), e pjesërisht edhe me rrugë të ndërmjetme nëpërmjet arumanishtes, si p.sh. leksemat *katun* m., *katunka* f., *lama* (llajë), *strunga* (shtrungë) etj. Ndërkaq, nëpërmjet shqipes kanë hyrë në maqedonishten edhe një numër i konsiderueshëm fjalësh nga të turqishtes, si p.sh. *keçe* (< shq. keçe, çeçe < turq. keçe, kebçe), *kurdija* (< xhurdi < kürde), *gjum* (< gjym < gügüm), *aur* (< ahër < ahur), *bitisa* (< bitis < bitmek), *şaka* (< shaka < şaka) etj.; greqishtes *skepari* (< sqepar < skepari), *kazma* (< kazmë < kasma), *çkrapja* / *şkrapja* (< shkrap < shkorpios), *trendafil* < trendafilos) etj. Për këtë dëshmojnë format më të afërta të shqipes me të gjuhëve burimore dhe, nga ana tjetër, përdorimi a përhapja e tyre më e madhe në shqipen sesa në maqedonishten.”²⁹

Duke njohur maqedonishten nga afër, Q. Murati ndalet edhe në **albanizmat** në të folmet e fshehta maqedonase, duke i orientuar studiuesit edhe në një dukuri tjetër më interes studimor në fushën e sociolinguistikës. autori “Një deng albanizmash leksikore hasim edhe në argo (në gjuhët e fshehta maqedonase), të cilat “vlojnë” me fjalë shqipe, khs. *gura* (gur), *kale*, *kençe* (qen), *koka* (kokë), *goe* (gojë), *buza* (buzë), *mekra* (mjekër), *veshinja* (vesh) etj., si dhe në fushën e onomastikës – të toponimisë e të antroponimisë, te të cilat hasim po ashtu shumë fjalë shqipe si apelativa të fosilizuara, si p.sh.: *Arbanasi*, *Arbanasinec*, *Arbanaški*, *Arbanaško*, *Arbinovo*, *Arbanasa*, *Arbaneško Dolče*, *Bardoec*, *Darda Kula*, *Duškoec*, *Grika*, *Malimadi*, *Lumnica*, *Mburino*, *Gura*, *Katuništa*, *Kafa*, *Biran*, *Lulo*, etj.”³⁰

e.1. Më poshtë po japim disa nga albanizmat në maqedonishte:

²⁸ Q. Murati, *po aty*, f. 646.

²⁹ Q. Murati, *po aty*, f. 542.

³⁰ Q. Murati, *po aty*, f. 543.

Bal'a / Bal'o *m.* kafshë me një balë të bardhë në ballë a në trup, kalë, lopë, qen me pullë të bardhë në krye. Regjistruar për të folmet maqedonase të Tetovës (Stamatoski 1959: 93), Strugës, Manastirit dhe Prespës (Poloska: 1998, 125). Albanizëm ballkanik, që ka shkuar edhe në të tjera gjuhë (Çabej **SGJ I** 50; Murati 1990: 40).

Bal'a *arg.* Baltë për muratorët, në gjuhën e fshehtë të muratorëve të Bracigovës. Nga shq. *baltë* (Nasteva 1953; Atanasov 1976).

Bal'ik *m. dial.* Ovčarsko ili domašno kuće – qen i bariut ose qen shtëpiak. Regjistruar për rrethinat e Prespës (Poloska 1998: 125). Nga shq. *balë*, *balik*.

Baloška *f.* dele e zezë me një balë të bardhë në fytyrë (Popovski: 1970).

Balučina *f.* tufë flokësh, baluke (Golo Brdo 2006: 135).

Besalija *ark.* čovek od jaka vera (RMJ I 31) – njeri me besë të fortë, besali. Edhe në turqishten e Gostivarit *besali* (Poloska: 1998, 130), bashkuar me sufiksën e turqishtes - *li*.

Besa *vj.* Besa, vera, data reč (RMJ I 31). Albanizëm ballkanik që ka shkuar edhe në serbishten, bullgarishten, greqishten e re, arumanishten, turqishten (Hoxha: 2001); Çabej **SGJ I** 61; P. Skok **ERHSJ I** 140). Në maqedonishten përdoret edhe në shprehje të tilla si *nema besa, ne stoi na besa* (Koneski-Nasteva **MT I** 59). Edhe në prozën popullore maqedonase: *Vije da BESA vrzite; Tie na BESA ne stojat; Kako si Besa vrzifme* (Šapk. IzD 5; Murati 1990, 14). Përdoret edhe në maqedonishten e rrethinave të Shkupit, të Kumanovës, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Prilepit, Dibrës, Strugës etj. (Poloska 1998, 129), pra ka një shtrirje shumë të hapët në dialektet maqedonase.

Bija, *sh. bii dial.* Kerka (RMJ I 35). Nga shq. *bijë*. Fjalë e sferës familjare që përdoret me një kuptim përmbledhës, për një vajzë a një grua të re: *Bijo mori bijo* (A. Mazon). Përdoret në të folmet e maqedonishtes të rrethinave të Prespës, Manastirit, Prilepit, Strugës, Ohrit, Dibrës (Poloska: 1998, 30). Ndeshet edhe në disa të folme të serbishtes në Mal të Zi, në Kosovë e në Plavë (Hoxha 2001, 57; Murati 1990, 15).

Autori i veprës shkruan drejt metodologjikisht e shkencërisht se “Në temët e këtij materiali sigurisht se do të kenë mbetur pa u hetuar edhe elemente e huazime të tjera të shqipes në maqedonishten. Prandaj as me këtë fjalor që po paraqesim në vijim nuk mund të përmbillet e t’i vihet pikë kapitullit të huazimeve gjuhësore shqiptare-maqedonase, respektivisht fondit të albanizmave leksikore ç’kanë hyrë në maqedonishten në rrymë të kohëve e që vazhdojnë të hyjnë edhe sot e gjithë ditën. Ky kapitull gjithsesi duhet të gjurmohet edhe në të ardhmen gjithnjë me një rrugë dyfishe: në një anë që të pasurohet edhe me materiale të tjera të panjohura më parë, e në anën tjetër të

bëhet edhe një rivlerësim rreth disa huazimeve që mund të jenë me etimologji të dyshimtë.”³¹

e.2. E theksojmë se vepra *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të shqipes së Maqedonisë*, nuk është thjesht fjalor me lema leksikore e shpjegimet e tyre. Ajo është **enciklopedi** e shqipes truallsore në këtë areal gjuhësor. Këtë vlerë e shton ndjeshëm edhe sythi “Albanizma toponimike”. Autori shkruan se “Në nomenklaturën e onomastikës maqedonase ka shumë fjalë shqipe që kanë mbetur si apelativa të fosilizuara, qoftë si rezultat i ndikimit gjuhësor të drejtpërdrejtë në kontakt, qoftë si rezultat i procesit të asimilimit të popullsisë shqiptare në atë sllave, me ndërrim të substratit etnik, ku popullsia shqiptare ka ndërruar etninë ose është asimiluar, por topikët me burim shqiptar mbetën të pandërruar, të papërkthyer, pra e ruajtën burimin e primitivit.”³²

Duke lënë të flasin faktet dhe jo propaganda nacionaliste studiuesi pohon dhe debaton shkurtazi e pastaj jep lëndën toponomastike. Ai shkruan se “Nga burimet e literaturës e të terrenit këtu më poshtë do t’i sillemi një sasi topikësh jo të pakët ç’përmbajnë elemente të shqipes a që dalin të jenë me burim shqiptar e që rrojnë edhe sot e gjithë ditën në gojë të popullsisë maqedonishtfolëse. Në këtë fond topikësh ne kemi arritur të qëmtojmë nga burime të literaturës dhe të terrenit mbi 117 topoleksema të tilla, pa i marrë në shqyrtim këtu emrat e vendbanimeve, përkundër faktit që studiuesit ultranacionalist maqedonas Trajko Stamatoskit nga 1800 vendbanime në Maqedoni, vetëm 1 toponim (Qafë - Gostivar) i dalka me burim shqiptar, gjithnjë sipas tij, edhe kjo formë shqipe e greq. *Íavato* “premin” (*Standardizacijata na geografските iminja vo Republika Makedonija*, 104).”³³

Po japim disa toponime të tilla:

Arbanaško¹ – lokalitet, krahinë e madhe malore në rrethinën e Kumanovës, në të cilën përfshihen edhe shtatë vendbanime të tjera. Nga emri i vjetër etnik *Arbanas / Arbanash* (shqiptar).

Arbanovci – nekropol (varrezë) në Bajishte të Dibrës (Murati 1999).

Arbineš – lagje në Krushevë, banuar ndjeshëm me popullsi arumune. Ruan trajtën rumune *Arbin* prej *Arban* me zhvillimin fonetik të rregullt *a:i* (Murati 1999: 41).

Arbinovo – fshat i rrethit të Ohrit, tani i banuar me popullsi sllavomaqedonase. Ruan emrin e vjetër të shqiptarëve *Arban* me fonetikë arumune *Arbin* (Murati 1999: 40).

Arbina – vis në Podbregje të Tetovës (Trifunski 1976, 44).

³¹ Q. Murati, *po aty*, f. 543.

³² Q. Murati, *po aty*, f. 580.

³³ Q. Murati, *po aty*, f. 580.

Arbino – vendbanim i zhdukur i antikës së vonë (Rotince, Tetovë), ku janë gjetur themele objektësh, enë qeramike etj. (Murati 1999: 44; Petruševski 1999: 11).

Arbino – vend në Pollog në rajonin e fshatit Podbregje (Petruševski 1999: 11).

e.3. Këtë pjesë (Albanizma toponimikë) e ndjek sythi “Albanizma patronimike”. Q. Murati shkruan se “Në gjurmimin e emrave familjarë shqiptarë të maqedonasit a në hetimin e patronimikave shqiptare të maqedonizuara, kemi qëmtuar këtu disa vëllime antropogjeografike dhe të fushave të tjera gjuhësore (shih literaturën e plotë që po e sjellim në fund të punimit), si dhe *Regjistrin e numrave telefonikë të Maqedonisë (RI)*, i cili përmban një fond mjaft të pasur të mbiemrave familjarë (Patronimikave maqedonase). Patronimikat shqiptare të maqedonizuara nga pikëpamja gjuhësore në thelb e ruajnë leksikun apelativ të shqipes, veçse dalin me formante prapashtesore slave (prej *ç-ov*, *-ski*, *-iq*, *-ovski*, *-ci* etj., khs. *Arnaudovski*, *Bibovci*, *Çobanov*, *Cekiq*, *Fushqit* etj. Ndërkaq, një numër të këtyre patronimeve i ndeshim dhe pa prapashtesa sllave, që domethënë me formën e pastër shqiptare, khs. format e tilla *Kavaj*, *Kirjazi*, *Korkut*, *Tozi*, *Tufa*, *Zozi* etj.”³⁴

Po japim disa njësi për ilustrim, duke i mëshuar faktit se jo vetëm ka punuar si leksikograf, por edhe si gjuhëtar dhe portreti mozaik i shqipes në arealin e vet truallsor në Maqedoninë e Veriut është ndërtuar nga gurë të çmuar të mirëzgjedhur e të mirëgoditur.

Arbovci – emri i një familjeje në Prostranje të Kërçovës (Smiljanić Kičevija 483), e shpërngulur në Sofje dhe Amerikë, që ruan emrin etnik shqiptar *Arb*-të përhapur shumë në mesjetë sidomos në tërthoret e Maqedonisë së sotme jugosllave.

Balçevci – emër familjeje në fshatin Skrebatno të Ohrit. Patronime të këtilla dhe *Baltovci* në Midincë të Kërçovës (Smil. Kičevija 443) e *Balshiq* në Shkup (TI 52). Nga antroponimi shqiptar *Balë-a*, shumë i përhapur në mesjetë (Shuteriqi 1990: 296). Khs. për këtë dhe emrin e fisit shqiptar *Musbala* në Zajas të Kërçovës.

Burzevski (Shkup TI 67). E hasim me një përdorim shumë të shpeshtë dhe me forma të ndryshme dialektgjeografike, khs. këtu dhe *Burmuzovski* (Shkup TI 67, një kompozitë nga *Burrëmadh*), *Bureska* (Gostivar TI 439), *Burevski* (Manastir, Shkup TI 383, 667), *Buriloski* (Strugë TI 588), *Burovski* (Strumicë 595), *Burev*, *Burovski* (Shtip TI 642, Prespë TI 584), *Burzanovski* (Kumanovë 505), *Burnazov* (Valandovë TI 692). Rrjedh nga apelativi i shqipes *burrë*, shumë i përhapur edhe në patroniminë shqiptare (Shuteriqi 1990: 305).

³⁴ Q. Murati, *po aty*, f. 586.

Buzalko (Shkup TI 66). Të kësaj provenience dhe *Buzlievski, Buzliev* (Shkup TI 66. 667) e *Buzalkova*, të dalë nga emri i burimit shqiptar *Buzalë-a*, shumë i përhapur në mesjetë te shqiptarët (Shuteriqi 1990: 306), ky nga apelativi i shqipes *buzë* “usna”. Nga ky emër rrjedh dhe mbiemri familjar shqiptar *Buzhlja* në rrethin e Tetovës, topiku *Buzalkovë* fshat në rrethin e Velesit etj.

F. Vend të posaçëm në veprën që po shqyrtojmë, zë edhe pjesa “**Fjalor idiomatik shqip-maqedonisht** (Shprehje paralele shqip-maqedonisht, fraza me substancë idiomatike)”. Si në të gjithë krerët e sythat e Fjalorit, studiuesi Q. Murati edhe këtu fillimisht jep një parashtrim shkencor informues, i cili fthillon gjithë lëndën që pasqyrohet në vijim. Ai shkruan se “Shqipja dhe maqedonishtja si dy gjuhë të arealit ballkanik dhe njëkohësisht si dy gjuhë indoevropiane – atje degë më vete, që kanë qenë në kontakt dhe në bashkëjetesë të përhershme shekullore, kanë krijuar një radhë tiparesh të përbashkëta edhe në fushën e frazeologjisë e të mënyrave të të thënit.³⁵”

Dhe arsyetimi shkencor vazhdon më tej: “Idiomatika e ligjërimeve shqiptare në truallin e Maqedonisë ka shumë elemente të përbashkëta me atë gjegjëse të maqedonishtes. Gjuha shqipe dhe ajo sllave e rajonit të Maqedonisë kanë qenë në kontakt për një kohë të gjatë, më së paku 1000 vjet, e mund të thuhet madje 1500 vjet (E. Hamp). Në këtë lak kohe, në lëmin e frazave, shprehjeve e mënyrave të të thënit, që janë paralele në këto dy gjuhë, mund të evidentohet një hambar i madh me kokrra të këtij lloji të burimit popullor, letrar, publicistik, etj.”³⁶

Po japim edhe këtu për ilustrim disa nga këto paralele idiomatike:

Ai që e përzien mjaltin, i lëpin edhe gishtërinjtë - *Toj što go meša medot, i prstite gi liže.*

Ai stan atë bylmet ka (nga ai njeri s’mund të presësh tjetër gjë) - *Taa bačilo takva mast daje.*

As erë, as shi “nuk e kam të afërt familjarisht” - *Ni veter, ni dožd.*

As kripë, as sheqer - *Ni sol, ni šečer.*

As më hyn, as më del “nuk bëhem marak”. - *Ni mi vlezë, ni mi izleze.*

As në tokë, as në qiell - *Ni na nebo, ni na zemja.*

G. Në veprën *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të shqipes së Maqedonisë* kanë zënë një vend me peshë edhe qindra *etnografizma*. Ato shënojnë nocione të ndryshe që lidhen me festa pagane, fetare etj., me ngjarje të shënuara të jetës së njeriut, me lojëra fëmijësh etj. Këta etnografizma janë dhënë në fjalor jo si zëra leksikografikë, por si zëra etnografikë. Ata janë shpjeguar me një informacion shumë të gjerë etno-kulturor dhe mund të themi se më shumë se sa janë shpjeguar, ata janë fthilluar përmes një informacioni lëndor që lehtësisht

³⁵ Q. Murati, *po aty*, f. 607.

³⁶ Q. Murati, *po aty*, f. 607.

mund të zërë vend në një botim të mirëfilltë etnografik. Pavarësisht nga natyra e fjalorit gjuhësor, kjo përsëri është vlerë e shtuar e veprës, sepse trupëzon një punë të madhe e me interes të shumëfishtë (brenda- e jashtëgjuhësor).

Po japim disa syresh:

Kalaçtor/e, -ja *f. etngr.* ajo që zinte kulaçin e dasmës dhe ishte e pamartuar. *Kalaçtorja* zë tri kulaçe, brenda brumit fut pare. 3 bukët i ndan nusja me dhëndrin dhe *kalaçtorja* qëndron në mes. Si t'i godasin tri pare a dy djalit, e fiton djali, ai bëhet *domaçin*, a si t'i bie nuses ajo fiton. Gjatë këtij riti, këndojnë: *Kush ta zore kalaçin/ Burr da marre kovaçin!* (Pa.).

Nata e peshtelkave *f.* një natë para se të marrin nusen ose para dasmës së synetisë, kur vajzat dhe nuset vishen me kostumin tradicional kombëtar. Të gjitha pjesëmarrëset në këtë natë vështrojnë me xhelozë se cila nga dasmoret i ka më të bukura veshjet (RE).

Shumbría e dímnit (*Shën Mëria e dimnit*) *f.* dita kur fillojnë të mbahen kreshmët e Krishtlindjeve (4 dhjetor). Besimtarët për këtë kremte të vogël ndezin vetëm qirinj, në kishë ose në shtëpi. Për këtë festë urohet: *e gëzofshi ditën!* Përgjigja: *Na qoftë ndihmë Dita e Shumbrisë!* (RE.)

Shynzhérzhi i dimnit *m.* kremte e vogël, të cilën ortodoksët e fshatit Kiqinë të Rekës së Gostivarit e kremtojnë më 9 dhjetor, kurse ata të Nistrovës në muajin shkurt. Për këtë kremte ziejnë sarmë të krezhmta, pa mish (RE.).

Buk`e dhome *f.* përdoret për dikë kur shpëton nga ndonjë e keqe e papritur, si shprehje e bamirësisë së tij, sepse u ka dhënë bukë të tjerëve (Kër.).

Buk' nafóre *f.* bukë rituale që gatuhet për kremten e Kërshëndellave (RE.).

Buk'e ré *f. zool.* xixëllonjë, e cila paralajmëron kohën e të korrave, bukën e re (Kër.). *Buka t'reja* (Der.).

Bukët e kuláçit *f.* bukët të cilat ia vënë nuses në krye atë natë kur zihet kulaçi, me qëllim që nusja të vijë me bereqet te burri (MT.).

Java e Bárdhë *tf.* gjatë këtyre ditëve (16-22 shkurt) besimtarët ortodoksë të Rekës nuk hanë mish për nder të të vdekurve (RE.).

Autori, siç shihet, me vetëdije të plotë, edhe pse në kundërshti me parimet klasike të leksikografisë së përgjithshme shpjeguese, zërat që i përkasin kësaj shtrese, i ka dhënë si zëra enciklopedikë, me të dhëna të plota e informuese. Madje ka zëra që qëndrojnë si studime të mirëfillta, që rrokin faqe të tëra në Fjalor.

Megjithatë Fjalori kërkonte një dorë të fundit, për të krehur e për të tëharrur lëndë të tepërt, por edhe për të krijuar hapësira të reja në zërat leksikografikë, sidomos kur lidhen me etnografinë e të folurit. Zëri **Avdore**, trajton një fushë të veçantë etno-gjuhësore, ku mund të ndiqen izoglosia, dhe mjetet e realizimit të emërtimeve për bashkëshorten, të motivuara morfologjikisht e semantikisht nga emri i bashkëshortit:

Avdor/e, -ja *f.* gruaja e Avdiut; *Lazore* – gruaja e Lazamit, *Çukore* – gruaja e Shukriut, *Danore* – gruaja e Ramadanit (Zag., La.), kur burri nuk e

tërret gruan e tij me emër, që lidhet kjo me natyrën sociale a me ndjenjën e turpit. Në këtë lëmë, te thirrjet e grave sipas emrit të burrit, hyjnë dhe: *E Axhibeut, e Taipbeut* - gruaja e Haxhiut, gruaja e Taipit (Pre.); *e Kozmait* - shoqja, gruaja, bashkëshortja e Kozmait, *e Janit, e Mitit, e Pandeliut* (në krahinën e Myzeqesë); *Çe-Gjuros, çe-Pandit* - gruaja e Gjuros, gruaja e Pandit (në Arbënesh të Zarës); *She Memetja, she Islamja* - gruaja e Mehmetit, gruaja e Islamit (Opojë - Kosovë); *Bardheca* - gruaja e Bardhecit, *Rexhepa* - gruaja e Rexhepit (Malësia e Gjakovës); *Hakeshë, Ganeshë* - gruaja e Hakiut, gruaja e Ganiut (Çamëri); *Alicë, Kadricë* - gruaja e Aliut, gruaja e Kadriut, në ligjërimet shqiptare të Maqedonisë dhe të Shqipërisë së mesme; Kështu dhe në anët e Korçës: *Raqevica* - gruaja e Raqit, *Naqevica* - gruaja e Naqit, *Janaqit*, me një ndikim nga sllavishtja; *Hasane* - gruaja e Hasanit, *Halime* - gruaja e Halimit, *Zybere* - gruaja e Zyberit (Gj. Shkurtaj, Onomastikë dhe etnolinguistikë, 150). *Benovica* gruaja e kreshnikut *Beno Bajraktari*. *Benovicën e ka lanë me barrë*, kp. (Tet.).

Në veprën ka dhe shumë njësi me interes sociolinguistik, që u përkasin përshëndetjeve, mallkimeve, urimeve, zbulimeve etj.

H. Në veprën *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të shqipes së Maqedonisë* ka zënë vend edhe një **Fjalor toponomastik** (Leksiku toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë). Autori i veprës, duke synuar që vepra të jetë një enciklopedi e vërtetë e botës së shqiptarëve vendës në Maqedoni, me të gjithë komponentet tiparizuese, ka dhënë një pasuri të madhe të makro- dhe mikrotoponimisë së trojeve shqiptare në këtë shtet (mbi **5600** njësi). Sipas tij, “Fjalori përfshin: *emra qytetesh, fshatrash, lagjesh, arash, fushash, livadhesh, rrafshesh, brigjesh, kodrash, bjeshkësh, kepash, grykash, luginash, qafash, rrëzash, majash, pllajash, shpatësh, karpash, gurësh, malesh, pyjesh, shpellash, shkëmbinjsh, sullëresh, tumash, gjollash, ujërash, burimesh, krojesh, lumenjsh, përrenjsh, kullosash, kishash, vendesh kulturi*, etj., që përdoren apo që janë përdorur në gojën e shqiptarëve në vise të ndryshme të Maqedonisë. Ky fjalor nuk është shterues dhe se areali shqiptar në Maqedoni është shumë herë më i pasur se kaq.”³⁷

³⁷ Q. Murati shkruan se “Duke gjurmuar fjalorin toponomastik shqiptar të tërthoreve të Maqedonisë, ne gjejmë atje të dhëna shumë të rëndësishme për onomastikën shqiptare, një lëndë të vlefshme që mund të plotësojë në një masë të mirë mungesën e dokumenteve të shkruara (Gj. Shkurtaj). Kësisoj, topiku *Ara e Zhelit e Lajthitë e Zhelit* (Krushopek, Shkup) na dëshmon antroponimin e vjetër *Zhel-i*, i cili del dhe tek emri i fshatit *Zhelinë* (Tetovë); *Arat e Korres* ruan emrin vetjak *Kor-e*, që e hasim dhe tek emri i fshatit *Koroshisht* të Strugës. *Te Mullëjni Garanës* (Kolibare, Kërçovë) gjejmë emrin vetjak *Garanë*, i cili ruhet edhe tek emri i fshatit *Garanë* (Kërçovë); *Te Ar’e Pukit* (Sellcë, Tetovë), *Ar’e Tupukit* (Sllatinë, Tetovë) kemi emrin personal *Puk-i*, i cili duket se mbijeton dhe tek emri i krahinës *Pukë-a* (Shqipëria Veriore); *Te Kodr’ e Lanës* (Shtrazë, Kumanovë) duket të përmbahet emri vetjak *Lan-a*, sikurse edhe tek

Vepra sjell një pasuri të jashtëzakonshme, jo thjesht numerike, dhe në rrafshin gjeografik. Q. Murati shkruan se “Fjalorin toponomastik të shqiptarëve të Maqedonisë e kemi ndërtuar me lëndë toponimesh të qëmtuara nga burime të ndryshme të literaturës dhe të regjistruar vetë në këto rrethe: Strugë, Dibër, Reka e Epërme, Kërçovë, Gostivar, Tetovë, Shkup, Kumanovë, Veles, Prilep, Krushevë, Manastir, Prespë dhe Ohër. Në këto lakadredha u kemi rënë pëllëmbë më pëllëmbë mbi 200 vendbanimeve për të mbledhur topoleksemat e vendit në gojën e gjallë të popullit. Emrat i kemi shënuar ashtu siç i ka shqiptuar subjekti i lindur në vendin përkatës.”³⁸

Po japim më poshtë një numër të vogël toponimesh me interes, edhe gjuhësor, edhe etno-kulturor. Treguesit e motivimit, që mund të ndiqen në emërtimet njëfjalëshe, por dhe në ato dygjymtyrëshe, qoftë në gjymtyrën e parë, qoftë në të dytën e emërtimit të pathjeshtë, mbartin kujtesën historike kombëtare, mendësinë e banorëve shqiptarë në shekuj, pronësinë etj., duke treguar drejtpërdrejt dhe vendësinë këtyre banorëve dhe vazhdimësinë e të jetuarit e të banuarit në trojet e tyre etnike.

Ne jemi të një mendjeje me autorin e veprës kur thekson se “Shqipja – gjuhë e një populli që në pjesën më të madhe ka jetuar dhe jeton sot e gjithë ditën në vise malore, ka ruajtur mirë emrat me anë të të cilëve shënohen emërtimet e truallit dhe ato gjeografike. Po të merret e të shoshitet mirë fondi i përgjithshëm leksikor në cilindo fjalor të gjuhës shqipe, - bie në sy menjëherë se sasia më e madhe e inventarit leksikor në sferën e konfiguracionit të terrenit, - ka prejardhje indoevropiane; huazime ka fare pak (Ajeti 1989: 52).”³⁹

Guri Shypes – gur ku rrinë shqiponjat (Gur.).

Guri Tepseis – gur që ka formën e tepsisë (Kol.).

Sytë e Pelisterit – liqenet e Pelisterit (Xhin.).

Shkëmbi i Shkabonjës – mal (Kësh.).

Udha Llatinve – rrugë nëpër të cilën kalonin malësorët për në qytet. Në Kumanovë *llatin* d.m.th. “malësor”. Khs. dhe fraz. *Mos paç punë me llatin. Hiçju atij llatini!* (Op.).

Ujti Shllejshët – ujë i njelmët në fshat (Sll.).

emri i një rrjedhe të vogël ujore *Lanë* (Tiranë); Te *Kroj Lurës* (Veshallë, Tetovë) duket të kemi antroponimin *Lur-a*, sikurse dhe tek emri i krahinës *Lurë* në Shqipëri; te *Kumanica* – ara (Llazhec – Manastir) kemi emrin personal *Kuman*, etj. Po kështu janë me shumë interes dhe antroponimet e toponimizuar *Fiçi* (te *Ara Fiçit*), *Liu* (te *Ara Liut*), *Marte* (te *Arat e Martes*), *Odoman* (te *Arat e Odomanit*), *Var-i* (te *Arat e Varit*), *Libore* (te *Ar'e Libores*), *Tota* (te *Gura Totës*), *Bila* (te *Kroni Bilës*), *Bozi* (te *Gjuri Bozit*), *Hundaveci* (te *Gjuri Hundavecit*), *Siga* (te *Bunari Sigës*), *Dila* (te *Bregu Dilës*), etj.” Q. Murati, *po aty*, f. 765.

³⁸ Q. Murati, *po aty*, f. 644.

³⁹ Q. Murati, *po aty*, f. 643.

Madje edhe këtu, autori, si dhe herë të tjera, e thyen kufirin e dhënies së zërave toponomastikë në një vepër toponimigrafike. Në fjalor gjejmë zëra me informacion etnografik kureshtie.

Vorret e Krush (v) e – dy grupe varresh të vjetra, që ndodhen pranë njëri-tjetrit, në rrugën midis katundeve Sellcë dhe Llacë të Malësisë së Tetovës. Quhen dhe *Vorret e Lisecit* ose *Vorret e Xhermës*. Sipas legendës, lisecasit marrin nuse në Gjermë, kurse gjermasit marrin nuse në Sellcë, dhe krushqet e dy katundeve takohen ndërmjet Sellcës dhe Llacës dhe meqë nuk ia kanë lëshuar rrugën njëri-tjetrit vriten të gjithë, edhe nuset. Sipas traditave të vjetra, në rast takimesh të dy palë krushqve asnjëra palë nuk bën t'ia lëshojë rrugën tjetrës, sepse për atë palë krushqish që lëshojnë rrugë është dobësi e madhe, nënçmim, përrulje, jo vetëm për krushqit dhe dasmorin, por për mbarë katundin, duke i marrë si njerëz frikacakë, si burra grash (F. Sulejmani, *Lindja, martesja dhe mortja në Malësitë e Tetovës*, Rilindja, Prishtinë, 1988, 227). Topoleksma *Vorret e Kruçve* është e përhapur gjithandej truallit shqiptar. Për këtë arsye, krushqit kur shkojnë të marrin nuse, ndërrojnë rrugë.

Rëndësia e këtij fjalori brenda fjalorit si vepër e plotë, jepet nga vetë autori. Ai shkruan se “Fjalori toponomastik ka vlera të pallogaritshme etnolinguistike, kulturore, historike etj. Në emërtesën e këtij vendi të quajtur Maqedoni ruhet emri i vjetër nacional i shqiptareve në formë të toponimizuar *Arbanash, Arbanashk*; emrat vetjakë, sot të zhdukur, si: *Shit (Gropa e Shitit), Var (Arat e Varit), Marte (Arat e Martes), Lepur (Arat e Lepurit), End (Ara Endit)*, etj. Në toponomastikonin e viseve shqiptare të Maqedonisë hasim dhe emër vende me apelativa sinonimikë: *lumë* e *zall* me kuptimin “lumë”, *birë* e *vonçkë* “birë”, *udhë* e *vrom* “rrugë”, *shpellë* e *peshtere* “shpellë”, etj.”⁴⁰

Dhe si në çdo pjesë e syth, edhe këtu ripohohet shqetësimi i gjuhëtarit të përkushtuar me ndjenjë kombëtare. Sipas Qemal Muratit, “Ky fjalor nuk është shterues dhe se areali shqiptar në Maqedoni është shumë herë më i pasur se kaq. Kanë mbetur jashtë veprës një numër shumë i madh toponimesh, të cilat duhet të mblidhen dhe të sillen në një botim tjetër të dytë. Leksiku toponimik duhet të qëmtohet i tëri nga goja e popullit dhe t’i shpëtojë bjerrjes së tij, sa nuk është tretur si kripa në ujë.”⁴¹ Madje ai e sheh punën shkencore në toponomastikë në një rrafsh përfshirës kombëtar, kur shkruan se “Në leksikografinë shqiptare mungojnë fjalorët toponomastikë, qoftë ata të tipit krahinor, pra për treva të veçanta, e qoftë të tipit të përgjithshëm, për mbarë truallin e gjeografisë shqiptare. Grumbullimi i lëndës toponomastike dhe hartimi i një fjalori toponimik shqiptar paraqet një detyrë të ngutshme për gjuhësinë tonë, sepse me zhvillimet e reja globalizuese rrafshuese edhe kjo

⁴⁰ Q. Murati, *po aty*, f. 765.

⁴¹ Q. Murati, *po aty*, f. 766.

pasuri e madhe gjuhe e kulturo-historike mund të bjerret, e bashkë me këtë të zhduken edhe kujtimet, traditat, legjendat, historia etj.

I. Fjalorin toponomastik e ndjek një **Fjalor patronimik**, në të cilin autori ka përfshirë rreth 810 njësi. Dhe këtu lënda e sjellë me kujdes nga autori mundëson vëzhgime të ndryshme për të parë elemente të shumta etnokulturore, fetare etj.

Burzevski (Shkup TI 67). E hasim me një përdorim shumë të shpeshtë dhe me forma të ndryshme dialektgjeografike, khs. këtu dhe *Burmuzovski* (Shkup TI 67, një kompozitë nga *Burrëmadh*), *Bureska* (Gostivar TI 439), *Burevski* (Manastir, Shkup TI 383, 667), *Buriloski* (Strugë TI 588), *Burovski* (Strumicë 595), *Burev*, *Burovski* (Shtip TI 642, Prespë TI 584), *Burzanovski* (Kumanovë 505), *Burnazov* (Valandovë TI 692). Rrjedh nga apelativi i shqipes *burrë*, shumë i përhapur edhe në patroniminë shqiptare (Shuteriqi 1990: 305).

Buzalko (Shkup TI 66). Të kësaj proveniencë dhe *Buzlievski*, *Buzliev* (Shkup TI 66. 667) e *Buzalkova*, të dalë nga emri personal i burimit shqiptar *Buzalë-a*, shumë i përhapur në mesjetë të shqiptarët (Shuteriqi 1990: 306), ky nga apelativi i shqipes *buzë* “usna”. Nga ky emër rrjedh dhe mbiemri familjar shqiptar *Buzhlja* në rrethin e Tetovës, topiku *Buzalkovë* fshat në rrethin e Velesit etj.

Uka (Belicë OS 21), *Ulkiq* (Manastir Ti 420). Patronimi i dytë zgjerim me prapashtesën serb *-iq* i emrit vetjak ose mbiemrit familjar shqiptar *Ujk-u*, shumë i shpeshtë në fjalorin patronimik shqiptar në mesjetë (Shuteriqi 1990: 369) dhe sot,. khs. këtu dhe *Ukajt* patr. në Zajas dhe Kollarë të Kërçovës, *Ukallarët* (Leshnicë-Kërçovë), *Ukallet*, *Uket* Sërbicë, Tuhin, Garanë – Kërçovë), *Ukallarët* (Sullarja e Poshtme – Derven), *Uka* mbiemër familjar në Gostivar, *Uklina* mb. fam. (Strugë), *Ukshetina* (Çegran – Gostivar).

i. 1. Pasuria që mbart vepra *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni* mund të shërbejë si një lëndë e bollshme dhe interesante për të sipërmarrë edhe **studime gramatikore, dialektologjike, etimologjike** etj. Sipas Q. Muratit në vepër janë pasqyruar dhe njësi që ndihin në punën studimore dhe studiuesit e historisë së saj, sidomos kur krahas studimeve etimologjike, ndërmerren studimet në rrafshin gramatikor e atë fonetik. Sipas tij, “Të folmet shqipe të Maqedonisë kanë edhe shumë fjalë të moçme të fondit amtar, si *bulktar* “bujk”, *shkal* “shkel”, *gjergunicë* “lehonë” (krahaso me kuptimin e foljeve *djerg* e *dirgjem*), *shklekë*, *shpojzë*, *vgjere* etj., të cilat, sigurisht, meritojnë përfillje të posaçme sidomos në hulumtimet rreth fonetikës historike të shqipes”.

Po ndalemi tepër shkarazi në fushën e morfologjisë së fjalëformimit e po japim vetëm dy fjalë të përngjitura, ndër qindra syresh:

Bythemikréy ndajf. 1. duke u rrokullisur kokë e këmbë, rrokullimthi; 2. fig. keq, rrëmujë, ngatërruar. *Pounët i ka bythemikrey* (Kër.). *Tengërling* (Kosovë). Arum. *Capshincur*; maq. *Gasprekuglava*.

Bythpërtermó ndajf. bythëpërpjetë (Kër.).

Fjalori sjell lëndë për t'i parë të gjitha mënyrat, tipet e mjetet e formimit të fjalëve. Po ilustruam me tri-katër mënyra:

- formimet me prejardhje (**Kafshitó** *fol.* bëj copë e grimë, e bëj kafshatë. *Mos e kafshito bukën* (Kër.) / **Kripaník, -u m.** lakror i gatuar me miell misri, me gjizë të kripur e me dhallë; zakonisht piqet në zjarr të hapur (Pre.). / **Laknisht ndajf.** mënyrë e të folurit. Për banorët e Nerezit të Epërm (në rrethin e Shkupit) mënyra e të folurit të Dervenit, Tetovës dhe Gostivarit quhet *laknisht*, sepse në ato të folme kanë zhvillime karakteristike të zanoreve (Ner.P.);

- me përbërje (**Këmbëkúqe, -ja f.** lloj lakrori që gatuhet me brumë të përvëlur në ujë e gjalpë, që përgatitet me rastin e dhënies së emrit fëmijës së porsalindur (Pre.) / **Morramadh mb.** njeri që ka morra. *Mos fli me at morramadh* (Cërn.). *Morramodh* (Kër.). *Morravec* (Tet.); **Morramadh mb.** njeri që ka morra. *Mos fli me at morramadh* (Cërn.). *Morramodh* (Kër.). *Morravec* (Tet.). me përngjitje (**Kamaskám/e, -ja f.** valle që luhet këmbë mbas këmbë (MT.) / **Kokëdënujë ndajf.** me kokë në ujë. *U oth dë gjolt kokëdënujë* (Pre.);

- me paranyjëzim të pjesores (**Trakalítur (i, e) mb.** i trullosur, i cokatur (Str.T.) etj.

i.2. Në këtë vepër madhore mund të sipërmerren edhe studime në **fushën e fonetikës dialektore**, për të ndjekur dukuri dhe procese që janë karakteristike për të folmet e gegërishtes lindore e asaj verilindore. Po japim vetëm një shembull: **Shnaik, -u m.** 1. enë e drunjtë për drithë, që ka shërbyer dhe si masë drithi. 2. mb. njeri me kokë të madhe. *E ka bo krazen sa ni shnaik* (PK). [Këtu kuptohet që bëhet fjalë për emrin **shinik (Shinik, -u m.** enë druri për të matur drithë (RE). Masë drithi prej 28 kg. (Pre.), në të cilin ka rënë i-ja paratheksore, kurse i-ja e theksuar është diftonguar.]

J. Jemi shprehur se puna e jashtëzakonshme të Q. Muratit për të hedhur në qarkullim veprën madhore me mbi 850 faqe, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, do të ishte shumë e shumë më e plotë, më e arrirë, nëse në këtë vepër me peshë në leksikografinë tonë, të ishte treguar më shumë kujdes për të dhënë më mirë elementet mbirreshtore, treguesit gramatikorë etj. Leksikografia jonë tashmë ka bërë zgjedhjet shkencore të mirëpranuara dhe ka krijuar gjedhet e dhura.

j.1. F.v., vjen për qindra njësi, formantet që ndërtojnë format e shumësit herë jepen, herë nuk jepen. Por kjo për punën e leksikografit që merret me fjalorët kombëtarë, krijon vështirësi për të dhënë normën gramatikore apo kodifikimin e saj te njësitë e pasqyruara në vepër, sepse materiali faktik nuk e sjell gjithnjë. Po japim disa emërtime që na çojnë te frymorë apo sende të numërueshme:

Balík, -u m. qen laraman (Pre.). *Láro* (Kër.).

Balín/ë, -a *f. sh. -a, -at.* vargje gjethesh duhani të bëra kurorë (Kër., Kr.).

Balíq/e, -ja *f.* lopë e larme (Gaj.). *Lárë* (Kër.).

Balósh, -i *m.* kafshë me njollë të bardhë në ballë (Kër., RE, Çe., Dib., Dob.).

Baloshan, -i *m.* cjan me balë në ballë (Gur.).

Balóshe *f.* lopë me njollë të bardhë në krye (MT., Dib.). *Baláshkë* (Dob.).

j.2. Kujdes duhej treguar dhe në ndonjë shpjegim kuptimor. Fjala vjen në zërin e mëposhtëm kuptimi i dytë është shpjeguar si folje (shpjegim me sinonimi). Kurse njësia është ndajfolje:

Berbat *mb.* i fëlliqur, i përlyer. *Ish bërë berbat e s`shihej me sy* (Pre.). I ndyrë, i përlyer (Der.). *Berbat i boni reshnët.* 2. I mundi, i fitoi. *Berbat i boni* (PK, Sog.). I shthurur, i ndotur, që nuk vlen për asgjë (Kër.). I ndotur, i fëlliqur (Dib.).

Si shihet autori ka bërë një punë shumë të mirë për **izoglosinë e njësisë** (dhe kjo duket në gjithë punimin dhe e ritheksoj se është vlerë e qenësishme e Fjalorit), por organizmi i brendshëm i mikrostrukturës së njësisë *Berbat* lë për të dëshiruar. Ilustrimet duhen grupuar sipas kuptimeve.

j.3. Gjithashtu, ndonjë njësi foljore, jepet në shpjegim si emër (me sinonimi emërore). Te rasti i mëposhtëm jeta e fjalës e shpërfaq njësinë si folje, treguesit gramatikorë jepen drejt si folje, kurse shpjegimi është i pasaktë: **Mërkeç** *fpv.* sëmundje e qenit, çartje, p.sh.: *Kana mërkeç çeni.* Këtë fjalë e hasim edhe si mbiemër në formën *i mërkeçëm*, p.sh.: *Ruju pi çenit t'mërkeçëm* (thuhet edhe *t'çartëm*), *se me t'kaç trenohësh.* Njerëzit e kësaj ane më parë besonin (pletqë besojnë edhe sot), se po të të kafshojë qeni i mërkeçëm, të bëhen këlyshët në krye (Kum.).

K. Së fundi, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipës në Maqedoni* ka rëndësi të madhe për leksikografinë dialektore, për leksikografinë kombëtare, për gjuhësinë e për mbarë kulturën shqiptare. Pasuria leksikore e frazeologjike e veprës është kombëtare dhe jo vetëm do të përfshihet në një fjalor të ardhshëm “tesaurus” të shqipës, por një pjesë me peshë e saj duhet të fitojë karakter normativ e të bëhet pjesë organike leksikut të shqipës standarde. Vetë autori i Fjalorit Q. Murati shkruan se “Në fjalorin e të folmeve shqipe të këtyre tërthoreve janë ruajtur shumë fjalë të vjetra të mëvetësishme, të gurrës shqiptare, dhe shprehje të veçanta frazeologjike, që meritojnë të futen në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe.”⁴²

Madje ai e orienton vetë punën në këtë kahe, duke u ndalur në disa njësi të përzgjedhura, që e ftillojnë dhe e arsyetojnë këtë mëtim të drejtë e shkencor. Ai shkruan se “Shumë prej fjalëve burimore të përfshira në këtë fjalor mund edhe të pasurojnë fondin e fjalëve shqipe. Të tilla janë, ndër të tjera, fjalë si: *brezare* “stoli argjendi që vënë nusët në brez”, *burrëmadhe* “gruaja që shkon

⁴² Q. Murati, *po aty*, f. 7.

burrë më burrë”, *endatore* “gruaja që end pëlhurë në tezgjah”, *lënoret* “vegël që përdoret për të lënuar leshin”, *lotmadhe* “gruaja që qan për pak a për shumë, që nuk i mban lotët”, *mashkullore* “grua që është si mashkull, që nuk i di punët e shtëpisë, që nuk i vjen ndoresh për punë grarishte”, *malmadh* “fatkeq, fatzi”, *pordhamadh* “njeri që shet dëngla, që krekoset, që shet mend”, *rródhë* “plot e përplot”, *shkathón* “ai që flet shpejt, shkathët”, *shkathtóre* “grua e shkathët në punë, e zhdërvjellët” *shpojzë* “gruaja që provokon gratë e tjera të qajnë në mort, provokatore”, *vraptar* “vrapues” etj.⁴³

Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni, si jemi shprehur dhe pak më lart, mbart një pasuri gjuhësore të madhe (ai është vepër *me mbi 20 mijë leksema, shprehje frazeologjike dhe toponime*). Por Q. Murati, është tërësisht i ndërgjegjshëm, se “Thesari leksikor e frazeologjik i këtij trualli është i pashtershëm si gurrat e kristalta malore të gjeografisë shqiptare. Ky thesar lypset që sa më parë të mblidhet kudo që flitet ndopak shqip e të vihet mbi një bazë shkencore të mirëfilltë, dhe të vëmë kështu në jetë porositë – testament që na lanë Gj. Pekmezi dhe D. Nikollë Gazulli në një vepër të këtyllë gjuhësore kombëtare, sepse dialektet tona kanë zënë të treten bashkë me pasurinë fjalësore e frazeologjike që ka endur gjuha jonë nëpër shekuj e mijëvjeçarë.”⁴⁴

⁴³ Q. Murati, *po aty*, f. 13-14.

⁴⁴ Q. Murati, *po aty*, f. 14.

